



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 477/1 prot.

Tiranë më 18.02.2026

Lënda: Mendim mbi projektvendimin për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të platformës elektronike të raportimit financiar (PERF)

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj me nr. 1232 prot., datë 10.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 477 prot., datë 11.02.2026, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të platformës elektronike të raportimit financiar (PERF)”, së bashku me relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i projektvendimit, në kuadër të garantimit të përputhshmërisë me ligjin nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji”) propozojmë të mbahen në konsideratë komentet dhe sugjerimet si më poshtë vijon.

Fillimisht vlerësojmë të rëndësishme të përcaktohet qartë baza ligjore që legjitimon “Komisionin Qendror të Zgjedhjeve” (në vijim “KQZ”) në cilësinë e Kontrolluesit, lidhur me përpunimin e të dhënave personale në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 7, të Ligjit. Vërejmë që kjo bazë ligjore mungon edhe në pjesën hyrëse, mbi të cilën mbështetet hartimi i këtij projektvendimi, duke parashikuar vetëm ligjin nr. 10325 datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

Sa i përket parashikimit të pikës 5, të projektvendimit sipas së cilit PERF do të ndërveprojë me bazën e të dhënave shtetërore të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, (për qëllime verifikimi të të dhënave personale të personave fizikë të përfshirë në procesin e raportimit financiar) vlerësojmë të sqarojmë si vijon.

Siç dhe jeni në dijeni, mënyra e përpunimit të të dhënave personale të gjendjes civile, aksesit në këto të dhëna, si dhe mënyra e ndërveprimit të databazave të tjera me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile gëzojnë një rregullim të posaçëm ligjor, konkretisht bazuar në pikat 2, 2/1 dhe 3, të nenit 3, të ligjit nr. 10129, date 11.05.2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar.

Me Udhëzimin e përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, të Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në pikën 20 të Aneksit 1, KQZ parashikohet se mund të aksesojë dhe përdorë këto të dhëna në zbatim të neneve përkatëse të Kodit Zgjedhor.

Megjithatë, duke qenë se po krijohet një platformë e re, dhe kërkohet akses në të dhëna personale (në funksion të një qëllimi tjetër sipas këtij projektvendimi), vlerësojmë të rëndësishme marrjen e masave për përditësimin apo shtimin e bazës ligjore specifike (në kolonën përkatëse të Aneksit 1 të Udhëzimit nr.463) që legjitimon këtë ndërveprim.

Në rastin konkret, mund të shtohet baza ligjore duke përfshirë nenin 15/2, të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar, i cili parashikon monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive politike nga KQZ, apo çdo referencë tjetër mbi të cilën legjitimohet ky akses apo ndërveprim.

Për sa më sipër, saktësimi i bazës ligjore nga KQZ, (duke paraqitur kërkesën mbi përditësimin në Aneksin 1, të Udhëzimit nr.463) garanton që çdo përpunim i të dhënave personale të jetë legjitim, i kufizuar, proporcional dhe në respektim të detyrimeve të legjislacionit në fuqi.

Ndërkohë, në përmbajtjen e projektvendimit vërejmë se nuk përcaktohet një rregullim i qartë mbi mbrojtjen e të dhënave personale gjatë administrimit, aksesimit dhe përpunimit të tyre në PERF. Në këtë kuadër, sugjerojmë që **pas pikës 5, të projektvendimit të shtohet një pikë e re**, me këtë përmbajtje: “Përpunimi i të dhënave personale në PERF të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Gjithashtu, konstatohet se **në pikën 6 të projektvendimit**, e cila lidhet me ruajtjen e të dhënave, mungon përcaktimi i afateve konkrete të ruajtjes së të dhënave personale si dhe i procedurave të anonimizimit ose shkatërrimit të tyre pas përfundimit të këtyre afateve. Në këtë këndvështrim sugjerojmë që institucioni administrues i kësaj data baze të përcaktojë fillimisht afatin e ruajtjes së të dhënave, në përputhje me qëllimin e përpunimit dhe legjislacionin e fushës. Ndërkohë pas fjalisë së pikës 6, të shtohet dhe fjalia me këtë përmbajtje “...Pas përfundimit të këtij afati, të dhënat personale fshihen ose anonimizohen sipas procedurave të institucionit administrues.”

Në përfundim, sugjerimet e mësipërme sjellin një zbatim më efektiv të legjislacioneve respektive, duke kontribuar në sisteme të qëndrueshme dhe funksionale, në përputhje me standardet e mbrojtjes së të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi